



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTERRI

Numri i lëndës: 2023:238398

Datë: 25.09.2024

Numri i dokumentit: 06204719

P.nr.303/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTERRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, në çështjen penale kundër të pandehurit L.L. nga komuna e Mitrovicës, për shkak të veprës penale Ngacmimi nga neni 182 par.1 e lidhur me par.4 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP-II.nr.1731/23 e datës 03.11.2023, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor publik të mbajtur me datë 18.09.2024, në të cilin ishin të pranishëm prokurorja e shtetit Vyrtyte Gërvalla, e dëmtuara H.S., i pandehuri L.L. dhe mbrojtësi i tij sipas autorizimit av.A.A., më datën 18.09.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 25.09.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI: L.L. nga i ati R..., e ëma B..., e gjinisë K..., data e lindjes.. në Vushtrri, me vendbanim në komunën e Mitrovicës, me numër personal ..., ka të kryer shkollën e mesme, punon në ndërmarrjen NTSH. “R...” në Mitrovicë, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, më parë i pa gjykuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Nga data 17.09.2023 e deri me datën 06.10.2023 rreth orës 23:25 në rr. “Komandat Haziri” ne Vushtrri, i pandehuri L.L. përmes telefonit, konkretisht përmes rrjeteve sociale “Viber” dhe “Tik Tok”, me qëllim të ngacmimit dhe frikësimit, në mënyrë të vazhdueshme i ka dërguar mesazhe të dëmtuarës H.S., e cila është edhe ish e dashura e të pandehurit, duke e kërcënuar me lëndime, vrasje atë dhe familjarët e saj përmes mesazheve të drejtpërdrejta, ku ndër të tjera thuhet: “Ja ki mu martu me mu me qef ja pa të vra nuk e la”, “Ka me të vra si me të vra reja me dorë tem”, “Ta pata premtu plumin në ball për këto sene”, “Nëse nuk del me mu ka me ta vra babën”, “Ko me ardh edhe pak met hi permas anej kah kuzhina per floksh met qit jasht”, si dhe duke e ngacmuar me dërgimin e fotografive të dëmtuarës tek familjarët e saj, me çka të dëmtuarën e vë nën frikë të arsyeshme për jetën e saj, jetën e familjarëve të saj apo lëndim të rëndë trupor dhe nën shqetësim të madh emocional,

- Me këtë ka kryer veprën penale Ngacmimi nga neni 182 par.1 e lidhur me par.4 të

KPRK-së

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 44, 69, 70, 182 të KPRK-së, si dhe nenit 242,320, 322, 364, 449 dhe 460 të KPPK-së, e

G J Y K O N

Të pandehurit: L.L. i shqipton dënim me burg në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit me rastin e shpalljes i është zëvendësuar në DËNIM MË GJOBË në shumën prej tremijë (3000) euro, i cili dënim do të ekzekutohet 15 ditë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në rast se i akuzuari refuzon të paguajë këtë dënim me gjobë, atëherë ky dënim me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, duke i caktuar të akzuarit për çdo 20 euro (njëzet euro) të dënimit me gjobë, nga 1 (një) ditë burgim.

Pala e dëmtuar ka hequr dorë nga propozimi për realizimin e kërkesës pasurore juridike lidhur me këtë çështje juridiko penale.

DETYROHET i pandehuri që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë euro (20€), si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej njëqind euro (100 €), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë PP-II II.nr.1731/23 e datës 03.11.2023, kundër të pandehurit L.L. nga komuna e Mitrovicës, për shkak të veprës penale Ngacmimi nga neni 182 par.1 e lidhur me par.4 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 15.12.2023, në të cilën seancë kanë prezantuar prokurorja e shtetit Vyrtyte Gërvalla, e dëmtuara H.S., i pandehuri L.L. dhe përfaqësuesi me autorizim av.A.A.. Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, gjyqtari i vetëm gjykues pasi bindet se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit iu jepet mundësia e deklaramit rreth fajësisë, i njëjti ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë. Gjyqtari i vetëm gjykues e ka njoftuar të pandehurin dhe mbrojtësin e tij se në afat prej 30 ditësh ata mund të paraqesin, kundërshtimet e tyre për provat e cekura në aktakuzë, si dhe kërkesë për hudhjen e aktakuzës.

Ku i pandehuri me anë të avokatit mbrojtës sipas autorizimit av. A.A. me datë 16.01.2024 pranë kësaj gjykate ka parashtruar kërkesë për hedhje të aktakuzës, të cilën gjykata me aktvendimin e datës 01.03.2024 e ka refuzuar si të pabazuar, i cili aktvendim pas kundërshtimit nga avokati mbrojtës është vërtetuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës me aktvendimin e datës 19.04.2024.

Deklarimi i të pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më datë 18.09.2024, ku pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, në kuptim të nenit 320 të KPPK-së, gjyqtari i vetëm gjykues pasi bindet se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i ofron mundësinë e deklarimit rreth fajësisë, ashtu që i pandehuri L.L. ka deklaruar se e pranon fajësinë, është penduar thellë për kryerjen e kësaj vepre, i premtion gjykatës që në të ardhmen kjo vepër apo vepra të natyrës tjetër nuk do të përsëriten më.

Deklarimet e palëve lidhur me pranimin e fajësisë

Prokurorja e shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se, i propozon gjykatës që të aprovoj pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri pasi që ky deklarim i tij vjen pas konsultimit me mbrojtësin e tij dhe njoftimin nga ana e gjykatës për pasojat dhe favoret e pranimit të fajësisë për të shtuar se si i tillë ky deklarim i tij gjen mbështetje në të gjitha provat që gjenden në shkresat e lëndës e si te tilla përtej dyshimit të bazuar mire e vërtetojnë gjendjen faktike që i vie në barrë të pandehurit. Ndërsa ne fjalën përfundimtare ka deklaruar se meqenëse i pandehuri e ka pranuar fajësinë, i propozon gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit të marr si rrethanë rënduese shkallën e lartë të dashjes në veprimet e të pandehurit të cilën e bazon në faktin se veprimet e tij ngacmuese në raport me të dëmtuarën përmbajnë fjalë kanosëse me të cilat e njëjta është kanosur për privim nga jeta, e atë në vazhdimësi ku në fotografit të cilat gjenden në shkresat e lëndës në 27 prej tyre shihet konsistenca në veprimet e të pandehurit në raport me të dëmtuarën ku vet përmbajtja e mesazheve si të tilla tregojnë që i njëjti veprën penale e ka kryer me dashje direkte apo thënë ndryshe me veprimet e tij konsumohet një shkallë e lartë e dashjes, si rrethanë tjetër rënduese të merret fakti se kjo vepër është kryer në raport me ish të dashurën çka si e tillë tregon edhe motivin për të cilën është kryer kjo vepër, po ashtu për shkak se nuk ka ndonjë certifikatë lidhur me të kaluarën kriminale të pandehurit i propozon gjykatës që sipas detyrës zyrtare të pajiset me një të tillë dhe varësisht se çfarë rezulton nga përmbajtja e saj të merret si rrethanë rënduese eventualisht lehtësuese. Ndërsa si rrethanë lehtësuese për matjen e dënimit të merret vetëm pranimi i fajësisë pasi që në këtë çështje penale në raport me të pandehurin sipas prokurorit të shtetit nuk ka asnjë rrethanë tjetër të vetme lehtësuese dhe i propozon gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit të i vlerësoj këto rrethana që janë propozuar nga prokurori i shtetit.

E dëmtuara lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se e mbështet fjalën e prokurores së shtetit si dhe njëherit heq dorë nga realizimi i kërkesës pasurore juridike lidhur me këtë çështje penale dhe pasi që e kanë përfunduar martesën kërkon që i njëjti të mos e pengoj në rrugë apo përmes rrjeteve sociale po ashtu as e njëjta nuk do ta e pengoj të pandehurin dhe kërkon që të merren masat ligjore që i njëjti në të ardhmen mos të e pengoj. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështet në tersi fjalën e prokurores së shtetit.

Avokati mbrojtës lidhur me pranimin e fajësisë ka deklaruar se pas pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit L.L. dhe pas konsultimit të mjaftueshëm me të njëjtin si mbrojtës konsideron se ky pranim i fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetshme duke kuptuar përgjegjësin e tij në raport

me këtë vepër dhe si të tillë i propozon gjykatës që ta aprovoj këtë pranim të fajësisë. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në lidhje me caktimin e llojit dhe të lartësisë së dënimit nga gjykata i propozon që si rrethanë lehtësuese të merr pranimin e fajësisë, ndjenjën e fajit, premtimin se në të ardhmen i pandehuri do të përmbahet nga veprimet joligjore ndaj të dëmtuarës H.S., e gjithashtu mos ta pengoj apo shqetësoj në jetën e saj private, po ashtu si rrethanë lehtësuese të merret edhe mosha relativisht e re gjatë kohës së kryerjes së veprës penale, se është mbajtës i familjes dhe është personi i vetëm që punon andaj një dënim i rëndë do ta dëmtonte ekonominë e familjes së tij. Andaj si përfundim i propozon gjykatës që të i shqiptoj një dënim me gjobë apo në rastin më të keq eventual një dënim me kusht.

I pandehur në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështet fjalën e avokatit mbrojtës.

Vlerësimi i Gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë

Në shqyrtimin gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues pas leximit të aktakuzën nga ana e prokurorit të shtetit në pajtim me dispozitat e nenit 320 të KPPK-së, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i njëjti, se pranimi i fajësisë mbështetet në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën, si: raporti fillestar i incidentit numër të rastit 2023-BC-1135, i datës 10.10.2023, procesverbali i marrjes në pyetje për të dëmtuarin H.S., i datës 10.10.2023, procesverbali i marrjes në pyetje për të dyshuarin L.L., i datës 11.10.2023, raporti i oficerit, i datës 10.10.2023, fotoalbumi në shtojcë i përbërë nga 28 fotografi.

Gjendja faktike e vërtetuar

Bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike, se i pandehuri ka kryer veprën penale Ngacmimi nga neni 182 par.1 e lidhur me par.4, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në nenin 182 par.1 të KPRK-së është përcaktuar se formën themelore të veprës penale ngacmimi e kryen “Kushdo që përfshihet në një sjellje të vëmendjes së vazhdueshme dhe të padëshirueshme ose komunikon me qëllim të ngacmimit, frikësimit, lëndimit, dëmtimit të pasurisë apo vrasjes së personit tjetër ose fëmijëve të tij, familjes, të afërmve apo kafshëve shtëpiake ose kushdo që vë tjetrin nën vëzhgim me qëllim të ngacmimit, frikësimit, lëndimit, dëmtimit të pasurisë apo vrasjes së personit tjetër ose fëmijëve të tij, familjes, të afërmve apo kafshëve shtëpiake; dhe gjatë këtyre veprimeve vë atë person nën frikë të arsyeshme nga vdekja, lëndimi i rëndë trupor, dëmtimi i rëndë i pasurisë ose nën shqetësim të madh emocional, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.”. Ndërsa në nenin 182 par.4 të KPRK-së është përcaktuar se “Vëmendja apo komunikimi nga paragrafi 1. i këtij neni mund të përfshijë përcjelljen apo qëndrimin në pritje; shfaqjen e vazhdueshme të shtëpia, shkolla, puna apo qendra rekreative; përsëritjen e thirrjeve telefonike; dërgimin apo lënien e porosive; dërgimin e mesazheve telefonike, letrave postare apo postës elektronike; ose lënien apo dërgimin e dhuratave të padëshiruara apo të gjësendeve tjera.”.

Andaj, bazuar në të lartcekurat, gjykata ka vendosur që të pandehurin ta shpall fajtor për kryerjen e veprës penale Ngacmimi nga neni 182 par.1 e lidhur me par.4 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtat është edhe penalisht përgjegjës.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit, bazuar në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, kjo gjykatë si rrethana lehtësuese ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, premtimin e të njëjtit se në të ardhmen nuk do të përsëris veprën penale, pendimin e tij për kryerjen e veprës penale, se është mbajtës i familjes dhe faktin se nuk ka qenë më parë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata ka gjetur intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur, faktin se kjo vepër është kryer brenda marrëdhënies familjare dhe vetë ligji e parasheh si rrethanë rënduese.

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi me burg në kohëzgjatje prej 6 muaj i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit i është zëvendësuar në dënimi me gjobë në shumën prej tremijë (3000) euro i cili dënim do të ekzekutohet 15 ditë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.

Gjykata, duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se me këtë dënim të shqiptuar ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të njëjtit nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Arsyet lidhur me kërkesën pasurore juridike, shpenzimet e procedurës dhe kompensimin e viktimave të krimit

Vendimin lidhur me udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest të rregullt civil gjykata e ka marrë në bazë të nenit 460 të KPPK-së, pasi që pala e dëmtuar ka hequr dorë nga propozimi për realizimin e kërkesës pasurore juridike në shqyrtim gjyqësor.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par. 2 nën par. 2.6 të KPPK-së.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 36 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.303/2023, datë 25.09.2024

GJYQTARI
Agron Maxhuni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimi të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.